



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.152

13 nëntor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9824 datë 1.11.2007	Për akreditimin e organizmave të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë	4439
Ligj nr.9825 datë 1.11.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”	4443
Ligj nr.9826 datë 1.11.2007	Për disa ndryshime në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, të ndryshuar...	4445
Ligj nr.9827 datë 5.11.2007	Për një shtesë në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar	4446
Dekret nr.5512 datë 9.11.2007	Për emërim ambasadori	4446
Dekret nr.5513 datë 9.11.2007	Për emërim ambasadori	4447

LIGJ
Nr.9824, datë 1.11.2007

PËR AKREDITIMIN E ORGANIZMAVE TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat për krijimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit, fushat ku kryhet akreditimi dhe rolin e akreditimit në procedurat e autorizimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit në sferën e detyrueshme.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akreditim” është veprimtaria e një pale të tretë, që ka për qëllim shprehjen zyrtare të kompetencës së provuar të një organizmi të vlerësimit të konformitetit, për të kryer detyrat e përcaktuara në fushën e vlerësimit të konformitetit.
2. “Organizëm akreditues” është organizmi i ngarkuar me ligj për të kryer akreditimin.
3. “Certifikatë akreditimi” është një dokument ose një tërësi dokumentesh zyrtare, që deklarojnë akreditimin për një fushë të përcaktuar.
4. “Simbol i akreditimit” është një simbol i miratuar nga organizmi akreditues, i cili përdoret nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituar për të treguar akreditimin e tyre.
5. “Vlerësim konformiteti” është veprimtaria, që provon se janë plotësuar kërkesat e përcaktuara për një produkt, proces, sistem, person ose organizëm.
6. “Organizëm i vlerësimit të konformitetit” është organizmi, që kryen shërbime të vlerësimit të konformitetit.
7. “Testim” është përcaktimi i një ose më shumë karakteristikave të një objekti të vlerësimit të konformitetit, sipas një procedure.
8. “Kalibrim” është veprimi, i cili vendos lidhjen që ekziston në kushte të përcaktuara dhe që merret duke iu referuar një ose më shumë standardeve të matjes, ndërmjet treguesve të një sistemi matës dhe rezultatit të matjes, i cili përftohet duke përdorur sistemin matës.
9. “Inspektim” është shqyrtimi i projektit të një produkti, i një produkti, procesi ose instalimi dhe përcaktimi i konformitetit të tij me kërkesat specifike ose, në bazë të gjyqimit profesional, me kërkesat e përgjithshme.
10. “Certifikim” është veprimtaria e një pale të tretë, që provon përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara për produktet, proceset, sistemet ose personat.
11. “Teste të zotësisë” është përcaktimi i aftësisë kalibruese ose testuese të një laboratorit ose i aftësisë testuese të një organizmi inspektues, nëpërmjet krahasimeve ndërlaboratorike.
12. “Krahasime ndërlaboratorike” janë organizimi, kryerja dhe vlerësimi i testimeve ose i kalibrimeve të një mostre kalibrimi apo testimi i njëjtë ose i ngjashëm, nga dy apo më shumë

laboratorë, në kushte të paracaktuara.

13. “Mbikëqyrje” është tërësia e veprimtarive, me përjashtim të rivlerësimit, për të kontrolluar plotësimin e vazhdueshëm të kërkesave të akreditimit nga organizmi i vlerësimit të konformitetit të akredituar.

14. “Reduktim i akreditimit” është procesi i tërheqjes së akreditimit për një pjesë të fushës së tij.

15. “Pezullim i akreditimit” është procesi i deklarimit të pavlefshmërisë së përkohshme të akreditimit për një pjesë ose për të gjithë fushën e tij.

16. “Tërheqje e akreditimit” është procesi i ndalimit të vlefshmërisë së akreditimit për të gjithë fushën e tij.

17. “Zgjerim i akreditimit” është procesi i shtimit të numrit të shërbimeve të akredituara ose të fushës së akreditimit.

18. “Palë e tretë” është një person apo organizëm, i pavarur nga personi apo organizata, që ofron objektin dhe nga përdoruesit e interesuar për këtë objekt.

19. “Apelim” është kërkesa e një organizmi të vlerësimit të konformitetit drejtuar organizmit të akreditimit, për rishikimin e një vendimi për akreditimin e tij, të pafavorshëm për të, të marrë nga ky organizëm.

20. “Ankesë” është shprehja e pakënaqësisë, e ndryshme nga apelimi, nga një person ose organizatë, tek organizmi akreditues për veprimtaritë e këtij organizmi apo të organizmit të vlerësimit të konformitetit, të akredituar, për të cilën pritet një përgjigje.

21. “Kompetencë” është atributi personal i provuar dhe aftësia e provuar për të zbatuar njohuritë dhe mjeshtërinë.

KREU II ORGANIZIMI

Neni 3

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit

Për kryerjen e akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit krijohet Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, si i vetmi organizëm kombëtar akreditues në Republikën e Shqipërisë. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen akteve nënligjore për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Neni 4

Statusi

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është institucion buxhetor në varësi të ministrisë që mbulon ekonominë dhe tregtinë.

Kjo drejtori drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, i cili është nëpunës civil dhe ka autoritetin e përgjegjësive për marrjen e vendimit për akreditimin.

Nëpunësit e kësaj drejtorie, që ushtrojnë detyra të natyrës drejtuese, organizuese, mbikëqyrëse apo ekzekutuese gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”. Për punonjësit e tjerë, marrëdhëniet e punës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 5

Fushat e akreditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ofron shërbimin e akreditimit të:

- a) laboratorëve testues dhe kalibrues;
- b) organizmave certifikues të sistemeve të menaxhimit;
- c) organizmave certifikues të personelit;
- ç) organizmave certifikues të produkteve;
- d) organizmave inspektues;

- dh) organizmave që realizojnë teste zotësie dhe krahasime ndërlaboratorike;
- e) organizmave që prodhojnë materiale referuese të certifikuara.

Neni 6

Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ka këto përgjegjësi:

- a) përfaqëson Republikën e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë dhe europianë të akreditimit;
- b) bashkëpunon me organizmat kombëtarë të akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, apo për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- c) këshillon administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike;
- ç) mban, përditëson dhe jep të dhëna për statusin e akreditimit të organizmave të akredituar;
- d) bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrit, me ministritë përkatëse dhe me shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit;
- dh) kryen trajnime për fushën e akreditimit;
- e) ndërmerr veprimtari në fushën e krahasimeve ndërlaboratorike dhe të testeve të zotësisë;
- ë) merr të dhëna nga organizmat akreditues të vendeve të tjera për organizmat e akredituar prej tyre, të cilët kryejnë veprimtari në Shqipëri;
- f) u vendos gjoba subjekteve të paakredituara, apo të cilave u ka mbaruar akreditimi, në rastet kur ato përdorin simbolin e akreditimit;
- g) i trajton ankesat dhe apelimet për akreditimin, të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit.

KREU III

BAZAT, PARIMET, PROCEDURAT DHE TARIFAT E AKREDITIMIT

Neni 7

Baza ligjore

Veprimtaria e akreditimit në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi, në standardet ndërkombëtare për fushën e akreditimit dhe në dokumente të tjera, të nxjerra nga organizmat europianë dhe ndërkombëtarë të akreditimit.

Neni 8

Parimet e akreditimit

Akreditimi është vullnetar dhe bazohet në parimet e paanshmërisë, transparencës dhe kompetencës profesionale.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit është e pavarur nga çdo organizëm i vlerësimit të konformitetit dhe nuk përfshihet në veprimtaritë e këtyre organizmave.

Neni 9

Procedura e akreditimit

Akreditimi kryhet me kërkesën e palës së interesuar.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit harton procedurat për vlerësimin, dhënien, zgjerimin, refuzimin, reduktimin, mbikëqyrjen, pezullimin, tërheqjen e akreditimit dhe për trajtimin e ankesave

dhe të apelimeve për akreditimin. Këto procedura miratohen nga ministri që mbulon ekonominë dhe tregtinë.

Kontrolli dhe zbatimi i procedurave të mësipërme bëhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit.

Neni 10

Vlerësimi i kompetencës teknike të organizmave të vlerësimit të konformitetit të sferës së detyrueshme

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit kryen vlerësimin e kompetencës teknike, nëpërmjet akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit, që veprojnë në sferën e detyrueshme. Fusha e autorizimit, si organizëm i vlerësimit të konformitetit në sferën e detyrueshme, duhet të përfshihet në fushën e akreditimit.

Neni 11

Tarifat e akreditimit dhe miratimi i tyre

Tarifat për kryerjen e akreditimit, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji, propozohen nga ministria që mbulon ekonominë dhe tregtinë dhe miratohen nga Ministria e Financave. Të ardhurat e krijuara nga kryerja e akreditimit derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 12

Shpenzimet e akreditimit

Të gjitha shpenzimet e akreditimit të organizmave të vlerësimit të konformitetit mbulohen nga aplikuesi për akreditim.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 13

Kundërvajtjet

Përdorimi i simbolit të akreditimit nga subjekte të paakredituara apo që u ka mbaruar afati i akreditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë. Gjobat vendosen nga punonjësi i autorizuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit.

Neni 14

Ankimi administrativ

Kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet ankimi te Drejtori i Përgjithshëm i Akreditimit brenda 15 ditëve, i cili duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Akreditimit, ose kur ai nuk përgjigjet mund të bëhet ankimi në gjykatë brenda 30 ditëve.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 15

Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, Drejtoria e Akreditimit pushon së funksionuari dhe punonjësit

e saj kalojnë punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, në të njëjtin pozicion.

Neni 16

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Akreditimit i kalojnë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Certifikatat e lëshuara nga Drejtoria e Akreditimit njihen nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit dhe kanë të njëjtën vlefshmëri.

Procedurat e akreditimit, të filluara në përputhje me ligjin nr.9024, datë 6.3.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues dhe organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë”, do të kryhen në përputhje me këtë ligj dhe me akte të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

Neni 17

Shfuqizime

Ligji nr.9024, datë 6.3.2003 “Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues dhe organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5509, datë 9.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9825, datë 1.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9290, DATË 7.10.2004 “PËR PRODUKTET E NDËRTIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalia e tretë riformulohet si më poshtë:

“Procedurat e vlerësimit dhe të vërtetimit të konformitetit, në përputhje me specifikimet teknike, kryhen sipas nenit 12 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

2. Pika 2 riformulohet si më poshtë:

“2. Organet e caktuara për vërtetimin e konformitetit caktohen sipas nenit 14 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Neni 2

Në nenin 20 pikat 1 e 2 fjalët “Policia e Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar”.

Neni 3

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Njoha e deklarimeve dhe e miratimeve të sistemeve të huaja bëhet në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Neni 4

Në nenin 23 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2 fjalët “Policia e Ndërtimit” zëvendësohen me fjalët “Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar.”

2. Pika 3 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet për procedurat e vlerësimit të konformitetit zgjidhen në përputhje me nenet 21, 22, 23 dhe 24 të ligjit nr. 9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Neni 6

Ky ligj hyj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5510, datë 9.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9826, datë 1.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8402, DATË 10.9.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE NË NDËRTIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9, fjalia e parë e paragrafit të parë ndryshohet si më poshtë:

“Për të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3, zbatuesi i punimeve duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës dhe inspektoratin ndërtimor e urbanistik, në nivel bashkie/komune/qarku, përpara fillimit të punimeve.”.

Neni 2

Në nenin 15 fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

“Gjobat vendosen nga kryeinspektori i inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, me propozimin e inspektorëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 3

Neni 17 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 17

Kundër vendimit të dënimit me gjobë lejohet ankimi administrativ dhe gjyqësor, sipas rregullave dhe afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi. Ankimi administrativ dhe gjyqësor kundër vendimit të gjobës së inspektoratit ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut nuk pezullon ekzekutimin e tij.”.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5511, datë 9.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9827, datë 5.11.2007

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e deputetes Arenca Trashani,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Neni 1

Në nenin 8 pika 2 shkronja “a”, pas fjalës “Kryetarit të Këshillit të Ministrave” shtohen fjalët “zëvendëskryetarët e Kuvendit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5514, datë 12.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

DEKRET

Nr.5512, datë 9.11.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Gilbert Galanxhi, emërohet në detyrën e Ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë pranë Misionit të OSBE-së dhe Organizatave Ndërkombëtare, Vjenë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi**

DEKRET

Nr.5513, datë 9.11.2007

PËR EMËRIM AMBASADORI

Në mbështetje të nenit 92, pika “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Mimoza Halimi, ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Belgjikës dhe e Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Europian, rezident, emërohet ambasadore e Jashtëzakonshme dhe Fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Dukatën e Madhe të Luksemburgut, jorezident.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 13.11.2007
Doli nga shtypi më 13.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë